



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

Nr. 88 prot.

Tiranë, më 3 / 1 / 2024

UDHËZIM

Nr. 1, datë 3.1.2024

PËR
UNIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN ME QËLLIM RRITJEN DHE GARANTIMIN E
SIGURISË PUBLIKE NGA ZJARRI NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe nenin 24, shkronja "c", të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", duke pasur në konsideratë që ministri i Brendshëm ka në kompetencë orientimin e zbatimit të politikave të veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së, si dhe ka një ndërlidhje në ushtrimin e funksioneve në këtë fushë nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, strukturat e MZSH-së në bashki, Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit dhe inspektoratet e mbrojtjes së territorit në bashki,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për unifikimin e veprimtarisë së inspektimit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe koordinimin e veprimtarive inspektuese të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, strukturave të MZSH-ve dhe inspektorateve të mbrojtjes së territorit në bashki.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të sigurojë rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga zjarri dhe shpëtimin në shkallë vendi, rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të institucioneve të administratës në nivel qendror dhe vendor, si dhe identifikimin e rreziqeve nga zjarri për të reduktuar probabilitetin e fillimit të zjarreve.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen nga Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Kryetarët e Bashkive, strukturat e MZSH-ve dhe inspektorateve të mbrojtjes së territorit në çdo bashki, ministritë dhe institucionet qendrore, si dhe çdo person fizik dhe juridik.

KREU II
**RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR UNIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË
INSPEKTIMIT**

Neni 4
Veprimtaria e inspektimit të rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

1. Inspektimi i rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin realizohet nëpërmjet:
 - a) një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje 3 (tre) anëtarë;
 - b) një grupi inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje 6 (gjashtë) anëtarë, me përfaqësues nga IKMT, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe inspektorati i mbrojtjes së territorit në bashki.
2. Objektet/aktivitetet me risk të ulët dhe me risk të mesëm, sipas përcaktimit të udhëzimit nr. 81, datë 06.03.2020, “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e certifikatës së sigurisë nga zjarri” inspektohen nga një grup inspektimi, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, ndërsa objektet/aktivitetet me risk të lartë, inspektohen nga një grup inspektimi i përbashkët, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni.
3. Grupet e inspektimit në kuadër të parandalimit të zjarrit kanë të drejtë:
 - a) të kontrollojnë masat dhe mjetet e mbrojtjes nga zjarri në çdo objekt ku prodhimi ose aktiviteti që kryhet lidhet me substanca lehtësisht të ndezshme;
 - b) të inspektojnë çdo lloj objekti, instalime të ndryshme, produktet e ndërtimit të përdorura në objekt, si në fasadë, ashtu edhe në elementët konstruktive, sipas standardeve të miratuara për këtë qëllim, magazinime dhe mbajtje të mallrave, materialeve dhe dokumentacionin përkatës, që ka të bëjë me sigurinë nga zjarri, apo detyrimin e të punësuarve për zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, duke zbatuar programin e miratuar të ushtrimit të kontrollit;
 - c) të specifikojnë afatin për eliminimin e mangësive apo parregullsive në zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

ç) të mbajnë, për çdo objekt të kontrolluar, dokumentacionin përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe përcaktimeve të udhëzimit nr. 81, datë 06.03.2020, të Ministrit të Brendshëm.

4. Subjekti që kontrollohet dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e punimeve të objektit janë të detyruar të lejojnë kryerjen e kontrollit, të vënë në dispozicion të grupit të inspektimit të gjithë dokumentacionin në përputhje me kërkesat e akteve normative në fuqi, si dhe të ndihmojnë në shqyrtimin e tij.

Neni 5

Përbërja e grupeve të inspektimit

1. Grupet e inspektimit, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të neni 4, të këtij udhëzimi, përbëhen nga:

a) 2 (dy) përfaqësues nga shërbimit i MZSH-së në bashki, të caktuar nga Drejtori/Shefi i Sektorit të Shërbimit të MZSH-së në bashki;

b) 1 (një) inspektor i inspektoratit të mbrojtjes së territorit në bashki, i caktuar Kryeinspektori.

2. Grupet e inspektimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të neni 4, të këtij udhëzimi, përbëhen nga:

a) 2 (dy) përfaqësues nga Sektori i Shërbimit të MZSH-së në bashki, të caktuar nga Drejtori/Shefi i Sektorit të Shërbimit të MZSH-së në bashki;

b) 1 (një) inspektor i inspektoratit të mbrojtjes së territorit në bashki, i caktuar nga Kryeinspektori;

c) 2 (dy) inspektorë të IKMT të caktuar nga Kryeinspektori;

ç) 1 (një) përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 6

Rregullat për kryerjen e inspektimeve

1. Në rastet kur objekti i inspektimit për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin janë objekte që kanë përfunduar punimet e ndërtimit dhe është lëshuar certifikata e sigurisë nga zjarri, inspektimi kryhet në përputhje me rregullat procedurale të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe udhëzimin nr. 588, datë 26.10.2016, “Për mënyrën e evidentimit, shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe miratimin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes”, dhe grupi i inspektimit në çdo rast, kryesohet nga një inspektor i strukturave të MZSH në bashki ose inspektori i Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

2. Në rastet kur objekt i inspektimit për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin janë objektet që nuk është lëshuar certifikata e sigurisë nga zjarri, inspektimi kryhet në përputhje me rregullat procedurale të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin, legjislacionin për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe vendimin nr. 894, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njesisë vendore” dhe grupi i inspektimit, në çdo rast, kryesohet nga një inspektor i IKMT.

KREU III
RREGULLAT E VEÇANTA PËR ORGANIZIMIN E INSPEKTIMEVE

Neni 7

Masat për parandalimin e rrezikut nga zjarri

1. Për arritjen e qëllimit në pakësimin e rasteve të zjarreve, apo risqeve të lidhura me to, veprimtaria e strukturave inspektuese duhet të realizohet nëpërmjet instrumenteve të:

a) hartimit të plan-kontrolleve për inspektime në koordinim me strukturat e tjera të bashkisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe IKMT, të objekteve/aktiviteteve që paraqesin rrezikshmëri nga zjarri;

b) programimit nga strukturat e MZSH-së të aktiviteteve informative, sensibilizuese dhe trajnuese, kryesisht në objektet që ushtrojnë aktivitete didaktik (çerdhe, kopshte, shkolla, universitete) lidhur me komponentët e sistemit të reagimit kundër zjarrit, si dhe me masat që duhet të marrin administratorët e këtyre aktiviteteve, sipas parashikimeve të akteve që normojnë veprimtarinë e kësaj strukture;

c) organizimit të kontrolleve apo këshillimit të subjekteve të inspektuar, për zbatimin me korrektësi të kërkesave ligjore, nënligjore në fuqi;

ç) vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjektet e inspektimit;

d) dhënies së masave administrative në përputhje me detyrimin e përcaktuar në nenin 50, të ligjit nr.152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, si dhe sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 588, datë 20.10.2016, “Për mënyrën e evidentimit, shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe miratimin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes”, për eliminimin e rreziqeve që mund t’iu shkaktohen interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë, parashikuar nga legjislacioni i posaçëm për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 8

Klasifikimi i objekteve dhe hartimi i planeve të punës

1. Strukturat e shërbimit të MZSH-së klasifikojnë objektet në territorin e Bashkisë sipas rrezikshmërisë nga zjarri, në bazë të kategorive të përcaktuara në udhëzimin nr. 81, datë 06.03.2020, “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e certifikatës së sigurisë nga zjarri” dhe njoftojnë Ministrinë e Brendshme, Inspektoratin Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Kryetarët e Bashkive dhe inspektoratin vendor të mbrojtjes së territorit në bashki.

2. Bazuar në klasifikimin e tyre, strukturat e shërbimit të MZSH-së përcaktojnë planin mujor, planin tre mujor, planin gjashtë mujor dhe planin vjetor të punës, duke përcaktuar objektet që do të inspektohen me grup inspektimi sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të neni 4, ose me grup inspektimi të përbashkët, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të neni 4.

3. Për objektet që do të inspektohen me grup inspektimi të përbashkët, i kërkojnë Kryeinspektorit të IKMT dhe Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së caktimin e inspektorëve

përkatës. Kryeinspektori dhe Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së caktojnë inspektorët jo më vonë se 3 (tre) ditë pune, nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 9
Raportimi

Strukturat e shërbimit të MZSH-së raportojnë jo më vonë se data 5 (pesë) e çdo muaji, për veprimtarinë e kryer gjatë muajit paraardhës, pranë Ministrit të Brendshëm, Kryetarit të Bashkisë, Kryeinspektorit të IKMT dhe Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së për ecurinë e zbatimit të planeve të punës së inspektimit, gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve, si dhe çdo masë tjetër të marrë për të siguruar rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga zjarri dhe shpëtimin në territorin e Bashkisë së tyre.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 10
Klasifikimi i objekteve dhe miratimi i planeve të punës

Strukturat e shërbimit të MZSH-së klasifikojnë objektet dhe miratojnë planet e punës, sipas nenit 8 të këtij udhëzimi, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 11
Strukturat që ngarkohen më zbatimin

1. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi strukturat e shërbimit të MZSH-së në bashki, inspektoratet e mbrojtjes së territorit në bashki, Kryetarët e Bashkive, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.
2. Ngarkohet sektori i arkiv protokollit në Ministrinë e Brendshme për njoftimin e këtij udhëzimi.

Neni 12
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme.

MINISTRI

TAULANT BALLA

